VENDIM
Nr. 279, datë 21.5.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 858, DATË 29.12.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja "e", 19, pika 4, 21, pika 3, 23, pika 1, 29, pikat 1 e 6, 33, pika 6, 37, pikat 1 e 4, 56, pika 7, 81, pika 4, 84, pika 4, 91, pika 3, dhe 140, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 858, datë 29.12.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në ndarjen "C", të kreut II, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës "ç", të nënpikës 3.1, shtohen fjalitë, me këtë përmbajtje:

"Për studentët e huaj, vetëdeklarimi lëshohet nga vetë studentët e huaj. Gjithashtu, në mungesë të këtij vetëdeklarimi, vërtetimi i akomodimit mund të lëshohet nga institucioni i arsimit të lartë, nëse ky i fundit ofron shërbimin e akomodimit për studentët ose mund të lëshohet nga subjekte të tjera, që ofrojnë këtë shërbim;";

b) Në nënpikën 3.5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në shkronjën "a", pas fjalëve "... institucion arsimor shqiptar" shtohen "... pas verifikimit të dokumentacionit shkollor të të huajit nga institucioni i arsimit të lartë;";

ii. Në shkronjën "b", pas fjalëve "... të shkollimit" shtohen "... në vlerën 300 000 lekë në një bankë në vendin e origjinës;";

iii. Shkronja "c" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"c) Dëshmia e njohjes së gjuhës së programit të studimit/gjuhës së zhvillimit të procesit mësimor apo vërtetimi për pranimin në kursin përgatitor të gjuhës;".

2. Në kreun III bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në ndarjen "A" bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Në fund të shkronjës "a", të pikës 10, shtohet fjalia "Për të huajt, që qëndrojnë për motive studimi, pranohet edhe dokument vërtetues për burime të tjera, që rrjedhin nga një grant, një bursë studimi, një kontratë e vlefshme pune ose një ofertë pune, jo më pak se 300 000 lekë për person, për 1 (një) vit kalendarik.";

ii. Pas pikës 13 shtohet pika 14, me këtë përmbajtje:

"14. Institucionet arsimore/institucionet e arsimit të lartë raportojnë, në formë shkresore ose elektronike, si vijon:

a) Dërgojnë informacion periodik çdo 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo kohë kur kërkohet nga autoritetet vendore për kufirin dhe migracionin, lidhur me frekuentimin e procesit mësimor të studentëve të huaj të pranuar për të ndjekur programet arsimore, si dhe menjëherë në rastet kur marrin dijeni mbi informacione që mund të sjellin si pasojë anulimin e vizës;

b) Dërgojnë informacion, në çdo kohë pranë autoriteteve vendore për kufirin dhe migracionin, lidhur me problematikat e hasura me studentët e huaj;

c) Njoftojnë menjëherë autoritetet vendore për kufirin dhe migracionin lidhur me rastet e studentëve të huaj, që kanë ndaluar së ndjekuri përkohësisht apo përfundimisht studimet.";

b) Në shkronjën "a", të pikës 2, të ndarjes "C", bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

i. Nënndarja “ii” ndryshohet dhe bëhet:

“ii. paraqitjen e një vërtetimi depozite bankare personale në bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, jo më pak se 300 000 lekë për person, për 1 (një) vit kalendarik, ose të një dokumenti vërtetues për burime të tjera, që rrjedhin nga një grant, një bursë studimi, një kontratë e vlefshme pune ose një ofertë pune, jo më pak se 300 000 lekë për person, për 1 (një) vit kalendarik.”;

ii. Pas nënndarjes “iv” shtohet nënndarja “v”, me këtë përmbajtje:

“v. Vërtetim nga institucioni i arsimit të lartë, ku ndjek studimet i huaji për pajisjen me numër matrikullimi.”.

II. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku